



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:027193

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05730254

E.nr.770/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorës M.A. nga Shtimja, të cilën e përfaqëson av Labinot Buzuku nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, dhe shpërblimit jubilar, si dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 24.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.770/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.770/23, të datës 17.05.2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, të pagave jubilarë dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.208/21, të datës 28.09.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 19.12.2022, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 943.60 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.770/23, më datë 24.05.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi